



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2488/2 prot

Datë 10.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “E.B.S” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur INT”, me Nr. REF-88723-06-03-2026, me objekt: “Studim i Fizibilitetit për Projektin ‘Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Ujërave të Shiut në Qytetin e Vlorës”, me fond limit 25,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 7/21/2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “E.B.S” SHPK, me NIPT (K72014002P) dhe adresë Rruga Teodor Keko , pallati ALES Konstruksion , shkalla nr.1, kati 7-të. , Yzberish, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlore, me adresë: Sheshi "4 Heronjtë", Rruga Spiro Gjikhuri, Vlorë.

Në datën 07.08.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/7134 dhe me nr. 2488/2026 prot, datë 07.08.2026 e operatorit ekonomik “E.B.S” shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur INT”, me Nr. REF-88723-06-03-2026, me objekt: “Studim i Fizibilitetit për Projektin ‘Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Ujërave të Shiut në Qytetin e Vlorës”, me fond limit 25,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 7/21/2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesave të sipërcituar, u konstatua se objekti dhe përmbajtja e ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “E.B.S” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “E.B.S” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. A/2026/7134 dhe me nr. 2488/2026 prot, datë 07.08.2026, Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“Nuk plotesohen kriteret e mëposhteme : 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim. Vlera minimale e lejuar e perlllogaritur sipas metodes se mesiperme eshte : 21880950 lek.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 10.08.2026.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu